

SHTOJCA 7. PROJEKT-PROPOZIMI

PROJEKT-PROPOZIMI
STEMA E APLIKANTIT (ORGANIZATËS)

<i>TITULLI I PROJEKTIT (jo më shumë se tetë fjalë)</i>	
<i>EMRI I APLIKUESIT</i>	
<i>PARTNERËT (Përfitues të fondeve)</i>	
<i>BASHKËPUNËTORËT</i>	
<i>FUSHA PRIORITARE</i>	
<i>Nën prioriteti</i>	
<i>Objektivi/at e Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDG¹)</i>	<i>Zgjidhni numrin përkatës (1-17) duke treguar Objektivin e Zhvillimit të Qëndrueshëm primar dhe sekondar që lidhet me projektin tuaj. Për më shumë informacion, referojuni Aneksit C “Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm”.</i>
	Objektivi Primar
	Objektivi dytesor
<i>GRUPI I SYNUAR /NR I PËRFITUESVE DIREKT (nr dhe përqindja e përfaqësimit sipas seksit)</i>	
<i>VENDI I ZBATIMIT TË PROJEKTIT</i>	
<i>KOHËZGJATJA (nr i muajve)</i>	
<i>BUXHETI TOTAL</i>	
<i>Buxheti nën ReLOaD2</i>	

PËRMBLEDHJA

Megjithëse ky seksion jepet që në fillim, përmbledhja e projektit shkruhet vetëm pasi janë plotësuar të gjitha seksionet e tjera të projekt-propozimit. Përmbledhja e projektit përmban të gjitha elementet e projekt-propozimit, si:

1. Nevoja/çështja brenda komunitetit vendor
2. Arsyet dhe rëndësia e projektit për komunitetin vendor
3. Synimet
4. Grupi/et e synuar/a dhe përfaqësimi gjinor
5. Kohëzgjatja e zbatimit dhe buxheti
6. Metodatat e përdorura për të arritur qëllimet e projektit
7. Përfitimet e veprimtarive të propozuara për komunitetin vendor

Ky seksion nuk duhet të jetë më i gjatë se një faqe. Qëllimi është të jepet informacion për të gjitha seksionet e sipërpërmendura si dhe informacion përmbledhës për Komisionin e Vlerësimit. Përmbledhja është seksioni i parë i

¹ <https://albania.un.org/en/sdgs>

Sustainable Development Goals – SDGs). The Sustainable Development Goals (SDGs), also known as the Global Goals, were adopted by the United Nations in 2015 as a universal call to action to end poverty, protect the planet, and ensure that by 2030 all people enjoy peace and prosperity. More details in enclosed Annex C

projekt-propozimit që shqyrton Komisioni i Vlerësimit dhe, si rrjedhim, duhet të jetë e shkurtër, e strukturuar dhe pa ujëra të tepërta.

1. INFORMACION MBI ORGANIZATËN QË APLIKON

Ju lutemi kini parasysh se të dhënat e përfshira në këtë seksion do të përdoren për të vlerësuar plotësimin e kriterëve nga aplikantët. I gjithë informacioni i dorëzuar do të shihet nga Komisioni i Vlerësimit dhe do të vlerësohet me anë të tabelës së vlerësimit, sipas seksioneve eliminuese për kapacitetet financiare dhe operative të aplikantëve. Jepni informacion të hollësishëm për organizatën tuaj dhe kualifikimet e saj për zbatimin e projektit të propozuar. Bëni një përshkrim të shkurtër të historisë së organizatës suaj (**kur dhe si u krijua**), **misionin dhe vizionin** e saj, çfarë e bën të veçantë organizatën tuaj, objektivat dhe strategjitë kryesore për arritjen e këtyre objektivave.

INFORMACION PËR ORGANIZATËN

Misioni:	
Vizioni:	
Data dhe mënyra e krijimit:	
Qëllimet dhe strategjitë kryesore për arritjen e qëllimeve në përputhje me statutin:	

Përshkrim i shkurtër i skemës organizative dhe sistemit të vendimmarrjes:	
--	--

Bordi drejtues i Organizatës së Shoqërisë Civile (OSHC)/Personat kyçë në Organizatën e Shoqërisë Civile

Emri dhe mbiemri	Profesioni	Funksioni	Seksi	Vitet e përvojës në OSHC

Personat që planifikoni të angazhoni për zbatimin e projektit

Emri dhe mbiemri	Profesioni	Funksioni	Seksi	Vitet e përvojës në OSHC	Me kohë të plotë/të pjesshme

Nëse tabela e mësipërme përfshin partnerët dhe/ose konsulentët, ju lutemi përfshini edhe vendin e tyre të punës në kolonën e "Profesioni".

PROJEKTET E TANISHME DHE PËRVOJA E MËPARSHME NË BASHKËPUNIM ME DONATORËT

Projekti i zbatuar gjatë tri viteve të fundit:

Tema/Fusha	Emri i projektit	Donatori	Kohëzgjatja	Vlera	Nr i personelit të angazhuar (i ndarë sipas gjinisë)

Projektet e tanishme:

Tema/Fusha	Emri i projektit	Donatori	Kohëzgjatja	Vlera	Nr i personelit të angazhuar (i ndarë sipas gjinisë)

Hapësira e zyrave:

Në pronësi ose me qira:	
Në pronësi ose me qira me OSHC të tjera:	
Metra katrorë:	
A keni telefon/faks:	
A keni qasje në internet:	
A keni të gjitha pajisjet e nevojshme për zbatimin e projektit?	

2. HYRJE

Kur të plotësoni këtë seksion, është e rëndësishme të niseni nga premisa se donatori nuk ka njohuri të mëparshme për komunitetin tuaj vendor dhe problemet që po përpiqeni të zgjidhni. Ju lutem përshkruani se në çfarë mënyre lidhet projekti me një ose më shumë përparësi të thirrjes publike. Bëni një analizë të shkurtër të situatës dhe të rëndësisë së problemit që po përpiqeni të zgjidhni. Nëse është e mundur, jepni tregues të qartë statistikorë për problemin që po përpiqeni të zgjidhni. Një problem i kuptuar dhe përshkruar mirë përbën përligjjen kryesore për projektin. Ky seksion kërkon përgjigje për disa pyetje: Pse është faktikisht i nevojshëm projekti juaj? Përshkruani se cilës nevojë të rëndësishme i përgjigjet ai. E kujt është kjo nevojë? Si do të ndikojë tek burrat/djemet dhe gratë/vajzat në komunitet?

Problemi që po përpiqeni të zgjidhni dhe nevoja që kërkon përgjigje duhet të jenë të lidhura me synimin dhe qëllimet e organizatës suaj. Nëse projekti i përshkruar në propozim nuk lidhet me veprimtaritë e organizatës suaj, mundësia për të marrë mbështetjen financiare ulet.

I gjithë informacioni i dhënë do të shqyrtohet nga Komisioni i Vlerësimit dhe do të vlerësohet në tabelën e vlerësimit, nën seksionin eliminues RELEVANCA, pyetja 2.1.

Ky seksion nuk duhet të jetë më i gjatë se një faqe.

3. PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

Bëni një përshkrim të asaj që doni të bëni dhe si mendoni t'i arrini synimet tuaja. Ju lutemi jepni informacione për ndonjë cilësi shtesë të projektit tuaj, si për shembull, qasja e tij novatore dhe shembuj të praktikës së mirë. Kini parasysh se propozimi do të marrë një vlerësim më të lartë nëse bën avokaci për një qasje me bazë të drejtat, barazinë gjinore dhe ka ndikim mbi grupet e pafavorizuara. Nëse projekti përfshin partneritet, ju lutemi përshkruani rolin e partnerit dhe nivelin e përfshirjes së tij në zbatim. Ky seksion nuk duhet të jetë më i gjatë se një faqe.

I gjithë informacioni i dhënë do të shqyrtohet nga Komisioni i Vlerësimit dhe do të vlerësohet në tabelën e vlerësimit, nën seksionin eliminues RELEVANCA, pyetjet 2.4 dhe 2.5.

4. GRUPET E SYNUARA

Përcaktoni qartë grupin e synuar dhe nevojat e tij. Ju lutemi përcaktoni cilët janë treguesit e saktë të përfitimit nga ana e grupit të synuar. Nëse është e mundur, analizoni një numër burrash/djemsh dhe grash/vajzash brenda grupit të synuar. Ju lutemi rendisni gjithashtu të gjitha palët e interesuara, si ndërmjetësit dhe përfituesit përfundimtarë të projektit.

I gjithë informacioni i dhënë do të shqyrtohet nga Komisioni i Vlerësimit dhe do të vlerësohet mbi bazën e tabelës së vlerësimit, nën seksionin eliminues RELEVANCA, pyetjet 2.2 dhe 2.3.

Specifikoni grupin e synuar dhe tregoni përfitimet që do të ketë nga projekti. Projekti duhet të përmbajë një përshkrim të hollësishëm të madhësisë dhe rëndësisë së grupit të synuar, përfaqësimin gjinor, dhe në veçanti njerëzit që do të përfitojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë nga projekti. Analiza e hollësishme e grupit të synuar mund të bëhet për sa i përket përbërjes së tij etnike, moshës, statusit shoqëror, etj., duke pasur gjithnjë parasysh se secilit grup duhet t'i bëhet një analizë e strukturës gjinore. Nëse përgatitet një analizë e hollësishme, ju lutemi bashkëngjiteni atë si një shtesë e projekt-propozimit.

Ju lutemi siguroni që paraqitja e grupit të synuar të bëhet me ndjeshmëri gjinore (gjithmonë ndani numrat e grave, burrave, djemve e vajzave) së bashku me statusin e tyre të ndryshëm dhe ndikimet tek sekset e ndryshme.

5. QËLLIMI I PËRGJITHSHËM I PROJEKTIT

Objektivi i përgjithshëm shpjegon thelbin e problemit dhe rëndësinë e projektit, pra përfitimet afatgjata të grupit të synuar nga projekti. Rregullat për përcaktimin e synimi të përgjithshëm të projektit janë:

- 1. Projekti mund të ketë vetëm një synim të përgjithshëm.*
- 2. Synimi i përgjithshëm duhet të lidhet me vizionin e zhvillimit.*
- 3. Ndonëse është e vështirë, madje ndoshta edhe e pamundur, që të matet sukcesi në arritjen e synimit të përgjithshëm përmes treguesve të verifikueshëm, kontributi i tij për realizimin e vizionit përsëri duhet të përcaktohet.*

6. OBJEKTIVI I PROJEKTIT

Objektivi i projektit është të gjejë një zgjidhje për problemin, çka sipas një përkufizimi të gjerë, është një përshkrim i rezultatit të dëshiruar të projektit. Objektivat janë rezultate të verifikueshme të projektit, të paraqitura në mënyrë të tillë që mund të përcaktohet nëse, dhe në çfarë mase, është realizuar projekti. Për shembull, nëse objektivi kryesor është krijimi i një Këshilli Rinor në nivel kombëtar, atëherë nën-objektivat janë krijimi i këshillave rinore nëpër bashki, forcimi i strukturave të tyre, krijimi i rrjeteve, etj. Projekt-propozimi ka zakonisht 2 deri në 3 objektiva specifikë, megjithëse në praktikë është gjithashtu e mundshme të ketë vetëm një objektiv specifik. Është e rëndësishme që të gjithë objektivat, ose të paktën një prej tyre, të jetë me ndjeshmëri gjinore. Në hartimin e kësaj pjese të propozimit, ju lutemi siguroni lidhjen me kornizën logjike.

Ju lutemi mos harroni punën kërkimore të nevojshme për matjen me saktësi të suksesit të zbatimit të projektit.

7. REZULTATET E PRITSHME

Në këtë seksion, duhet të rendisni rezultatet e projektit. Kjo formon bazën mbi të cilën do të vlerësohet projekti. Rezultatet e pritshme janë më të hollësishme se synimi i përgjithshëm e objektivat, dhe këto duhet të verifikohen përmes treguesve të verifikueshëm objektivisht (TVO). Ky seksion nuk duhet të jetë më i gjatë se një faqe.

TVO duhet të jenë:

- *Konkretë: përcaktoni qartë çfarë, ku, kur dhe si e për kë do të ndryshojë situata; përcaktoni qartë përfaqësimin gjinor.*
- *Të matshëm: synimet dhe përfitimet janë të matshme nga ana sasimore; analiza e përfitimeve për të dy sekset është e mundshme.*
- *Të arritshëm: synimet mund të arrihen (duke marrë parasysh burimet dhe kapacitetet në dispozicion brenda komunitetit).*
- *Realiste: mundësia për të arritur atë nivel ndryshimi që pasqyron synimin.*
- *Të kufizuar në kohë: përcaktoni kohëzgjatjen në të cilën do të realizohet secili objektiv.*

Ju lutem siguroni lidhjen me kornizën logjike kur të hartoni këtë seksion.

8. AKTIVITETET

Ky seksion duhet të përfshijë një vështrim të përgjithshëm dhe përshkrim të veprimtarive që do të lejojnë arritjen e rezultateve të përcaktuara. Ato duhet gjithashtu të specifikohen në Planin e Veprimtarive, një nga shtojcat që janë pjesë e projekt-propozimit. Veprimtaritë duhet të jenë të qarta dhe konkrete. Përcaktoni lidhjen e qartë midis veprimtarive dhe synimeve të projektit dhe pastaj përshkruani se përse janë përzgjedhur këto veprimtari specifike. Veprimtaritë e pritshme duhet të grupohen dhe të lidhen me rezultatet relevante të projektit. Ky seksion nuk duhet të jetë më i gjatë se katër faqe.

9. HIPOTEZAT DHE RREZIQET

*Ky seksion duhet të identifikojë hipotezat dhe rreziqet e mundshme që mund të vënë në rrezik zbatimin dhe/ose suksesin e projektit. Ju lutemi kushtojini vëmendjen e duhur këtij seksioni, sepse ai është shumë i rëndësishëm për identifikimin e ngjarjeve dhe rrethanave në të ardhmen që mund të përbëjnë kërcënim ndaj zbatimit me sukses të projektit. Kjo do t'ju lejojë që të përgatisni një strategji për të shmangur ndonjë rrezik të mundshëm. **Ju lutemi siguroni lidhjen me kornizën logjike kur të hartoni këtë seksion.***

10. KOHËZGJATJA E PROJEKTIT

Ky seksion duhet të tregojë kohëzgjatjen e zbatimit të projektit.

11. MONITORIMI DHE RAPORTIMI

Monitorimi:

Monitorimi është mbledhja sistematike dhe analizimi i informacionit për ecurinë e projektit. Qëllimi është që të përmirësohet efektiviteti dhe efikasiteti i projektit. Monitorimi bazohet në paketën e rezultateve dhe veprimtarive të planifikuara, të përcaktuara në fazën e planifikimit. Ai ndihmon për të garantuar se zbatimi i projektit është në rrugën e duhur dhe bën të mundur që grupi drejtues të marrë informacione në kohë për çështje të ndryshme. Nëse kryhet ashtu siç duhet, ai përfaqëson një instrument të paçmuar për menaxhimin e mirë dhe krijon një bazë të mirë për vlerësimin. Monitorimi bën të mundur të konfirmohet nëse burimet në dispozicion janë të mjaftueshme dhe po përdoren me efikasitet, nëse kapacitetet ekzistuese janë të përshtatshme dhe nëse çdo gjë që është planifikuar është zbatuar.

Monitorimi:

- Është pasqyrim i planit të projektit,
- Ndodh gjatë zbatimit të projektit,
- Zhvillohet në përputhje me një kuadër kohor të përcaktuar më parë.

Ai realizohet mbi bazën e të dhënave (treguesve) sasiore dhe cilësore.

Ju lutemi jepni informacion se kush do ta monitorojë zbatimin e projektit, në çfarë mënyre dhe kur. Monitorimi është një opsion dhe nuk është i nevojshëm për të gjitha projektet. Megjithatë, projektet komplekse dhe të gjata mund të përfitojnë nga monitorimi.

Raportimi për përparimin e zbatimit të projektit dhe raportimi financiar duhet të specifikohen në projekt-propozim dhe duhet të paraqiten në formën e raportimeve të përdymuajshme për dinamikat (veprimtaritë/financat) e zbatimit të projektit brenda afateve kohore të përcaktuara. Përcaktoni gjithashtu se kur do të paraqitet raporti (përshkruesi) përfundimtar.

12. BUXHETI

Ky seksion duhet të përfshijë përshkrimin përshkrues të të gjitha linjave dhe nën-linjave të buxhetit.

Buxheti është shprehja e projektit në vlera monetare. Ky seksion duhet të përshkruajë shpenzimet e pritshme gjatë kohëzgjatjes së projektit. Linjat e buxhetit duhet të përbëjnë një rrjedhë logjike të metodës së punës dhe veprimtarive. Ju lutemi siguroni që sa më shumë linja që të jetë e mundur të bazohen në shpenzime të përcaktuara qartë, jo mbi vlerësime të përafërta. Është gjithashtu e dëshirueshme të tregohen burimet (e mundshme) të financimit nga donatorët e tjerë. Mos harroni kontributin tuaj për projektin (punë vullnetare, pajisje nga projektet e mëparshme, hapësirë pune, etj.). Informacioni në këtë seksion duhet të jetë realist, për shembull, ju nuk do të kërkonti blerje e një fotokopjuesi të ri që kushton 300 000 Lek nëse ajo nuk duhet për zbatimin e projektit.

13. DUKSHMËRIA/VIZIBILITETI

Dukshmëria (publiciteti) duhet të planifikohet siç duhet për të gjitha veprimtaritë e projektit. Dukshmëria duhet të fokusohet në zhvillimet dhe arritjet në zbatimin e projektit dhe jo në arritjet administrative ose procedurale.

Plani i dukshmërisë duhet të përfshihet në Planin e Punës dhe të buxhetohet siç duhet.

Dukshmëria e projektit duhet të informojë partnerët e projektit, grupet e synuara dhe publikun e gjerë për nismat dhe sukseset e projektit. Përcaktoni mjetet e promovimit dhe shpjegoni se si dhe në çfarë faze planifikoni t'i përdorni, përfshirë veprimtaritë publike (konferenca shtypi, botime dhe artikuj gazetash, faqe interneti, pankarta, pllakate, materiale promovuese, fotografi dhe materiale të tjera audio-vizuale, vizita publike, etj.). Ky seksion duhet të përshkruajë se çfarë duhet të bëni dhe si planifikoni të promovoni veprimtaritë tuaja. Veprimtaritë promovuese duhet të jenë të qarta, specifike dhe me ndjeshmëri gjinore.

Lista e dokumenteve:

Shtojca 7 Projekt Propozimi

Shtojca 8 Buxheti

Shtojca 9 Korniza Logjike

Shtojca 10 Plani i Aktiviteteve dhe dukshmërisë

Shtojca 11 Formulari i identifikimit administrativ

Shtojca 12 Formulari i identifikimit financiar

Shtojca 13 Deklarata për plotësimin e kriterëve

Shtojca 14 Lista e kontrollit

Shtojca A Deklarata e partneritetit

Shtojca B Deklarata për shmangien e konfliktit të interesit

Shtojca C Objektivat për Zhvillim të Qëndrueshëm